



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1586/1 Prot

Tiranë, më 11.11.2019

### V E N D I M

Nr.129, datë 11.11.2019

***“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Lushnje, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lushnje,

### VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje

*me parimet e ligjit për nëpunësin civil*”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Lushnje.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Lushnje, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. 193, datë 6.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë Lushnje “Për miratimin e strukturës organizative të bashkisë për vitin 2019”, e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Lushnje, së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **149** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **4** pozicione të kategorisë së lartë drejtuese, **10** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **13** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **122** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Aktualisht institucioni, po punon për hartimin e një strukture të re organizative, përgatitja e të cilës është në proces.

Në momentin e verifikimit, u konstatua se, në Bashkinë Lushnje, në 6 raste në pozicione të shërbimit civil janë emëruar punonjës me ngritje në detyrë në kundërshtim me ligjin dhe në 36 raste punonjësit janë emëruar pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me akt të nxjerrë nga titullari i institucionit, në kundërshtim me ligjin, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të menaxhimit të tokës bujqësore”, akti nr. 156, dt. 26.4.2016, (emërimin e rregullt në shërbimin civil e ka në pozicionin Specialist i nivelit të lartë për infrastrukturën, si punonjës ekzistues, parashikuar nga neni 67 i ligjit).
2. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Zyrës së Veterinarisë”, akti nr. 19, dt. 31.3.2014, (emërimin e rregullt në shërbimin civil e ka në pozicionin Specialist i nivelit të lartë për veterinarinë, si punonjës ekzistues, parashikuar nga neni 67 i ligjit).
3. \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore”, akti nr. 25, dt. 9.4.2014, (emërimin e rregullt në shërbimin civil e ka në pozicionin Specialist i nivelit të lartë për biznesin e madh dhe tregun, si punonjës ekzistues, parashikuar nga neni 67 i ligjit).

4. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të kontrollit dhe inspektimit”, akti nr. 78, dt.19.4.2016, *(emërimin e rregullt në shërbimin civil e ka në pozicionin Specialist tatim - takse, në Njësinë Administrative Golem, si punonjës ekzistues, parashikuar nga neni 67 i ligjit).*
5. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të urbanistikës”, akti nr. 104, dt. 16.10.2015, *(emërimin e rregullt në shërbimin civil e ka në pozicionin Specialist i nivelit të lartë për studime dhe projekte, si punonjës ekzistues, parashikuar nga neni 67 i ligjit).*
6. \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse”, akti nr. 87, dt. 20.4.2016, *(emërimin e rregullt në shërbimin civil e ka në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Personelit, si punonjës ekzistues, parashikuar nga neni 67 i ligjit).*
7. \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Zhvillimit Rural”, akti nr. 40, dt. 8.4.2016.
8. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë”, akti nr. 19, dt. 23.2.2017.
9. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë”, akti nr. 18, dt. 23.2.2017.
10. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për pyjet”, akti nr. 137, dt. 26.4.2016.
11. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për kullotat”, akti nr. 106/1, dt. 7.7.2017.
12. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për këshillimin dhe asistencë në terren”, akti nr. 183, dt. 9.5.2016.
13. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë veteriner”, akti nr. 20, dt. 31.3.2014.
14. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë veteriner”, akti nr. 145, dt. 26.4.2016.
15. \*\*\*\*\*, “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike”, akti nr. 85, dt. 3.7.2019.
16. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për mjedisin”, akti nr. 207, dt. 9.6.2016.
17. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për investimet”, akti nr. 3, dt. 4.2.2015.
18. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për PAK”, akti nr. 44, dt. 11.4.2016.
19. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për PAK dhe Ndihmën Ekonomike”, akti nr. 208/1, dt.16.6.2016.
20. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për biznesin e vogël”, akti nr. 27, dt. 23.2.2017.
21. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për biznesin e madh”, akti nr. 34, dt. 28.2.2017.
22. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për taksën familjare dhe taksën e tokës bujqësore”, akti nr. 21, dt. 23.2.2017.
23. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për kontrollin dhe inspektimin”, akti nr. 106, dt.7.7.2017.
24. \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë Juridike”, akti nr. 180, dt. 9.5.2016.
25. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Zyrë së prokurimeve”, akti nr. 66, dt. 25.4.2017.
26. \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për IT”, akti nr. 108, dt. 16.10.2015.
27. \*\*\*\*\*, “Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës”, në Njësinë Administrative nr. 1, akti nr. 25, dt. 1.3.2018.

28. \*\*\*\*\*, “Inspektor i ndihmës ekonomike”, në Njësinë Administrative nr. 1, akti nr. 102/1, dt. 12.10.2015.
29. \*\*\*\*\*, “Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës”, në Njësinë Administrative nr. 3, akti nr. 17, dt. 23.2.2017.
30. \*\*\*\*\*, “Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës”, në Njësinë Administrative nr. 4, akti nr. 49, dt. 27.2.2015.
31. \*\*\*\*\*, “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Bubullimë, akti nr.118, dt. 25.4.2016.
32. \*\*\*\*\*, “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Bubullimë, akti nr.177/1, dt. 3.5.2016.
33. \*\*\*\*\*, “Inspektor financë/arkiv/protokoll”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 102, dt. 21.4.2016.
34. \*\*\*\*\*, “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 103, dt. 21.4.2016.
35. \*\*\*\*\*, “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 124, dt. 25.4.2016.
36. \*\*\*\*\*, “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Dushk, akti nr. 40, dt. 7.3.2017.
37. \*\*\*\*\*, “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Karbunarë, akti nr. 67, dt. 19.4.2016.
38. \*\*\*\*\*, “Inspektor i tatim-taksave”, në Njësinë Administrative Ballagat, akti nr. 115, dt. 20.7.2017.
39. \*\*\*\*\*, “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Ballagat, akti nr. 108, dt. 21.4.2016.
40. \*\*\*\*\*, “Inspektor i financës”, në Njësinë Administrative Fier Shegan, akti nr. 79/1, dt.1.9.2015.
41. \*\*\*\*\*, “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Krutje, akti nr.101, dt. 21.4.2016.
42. \*\*\*\*\*, “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Krutje, akti nr.104, dt. 6.7.2017.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë, ashtu edhe të njësive administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të

ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Lushnje, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit në fjalë dhe nisur nga detyrimi i parashikuar në nenin 111, të ligjit si më lart, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV, *“Pranimi në shërbimin civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i*

Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendim nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Lushnje, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara si më poshtë:
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të menaxhimit të tokës bujqësore”, akti nr. 156, dt. 26.4.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Zyrës së Veterinarisë”, akti nr. 19, dt. 31.3.2014.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore”, akti nr. 25, dt. 9.4.2014.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të kontrollit dhe inspektimit”, akti nr. 78, dt.19.4.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të urbanistikës”, akti nr. 104, dt. 16.10.2015.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse”.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Zhvillimit Rural”, akti nr. 40, dt. 8.4.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë”, akti nr. 19, dt. 23.2.2017.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë”, akti nr. 18, dt. 23.2.2017.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për pyjet”, akti nr. 137, dt. 26.4.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për kullotat”, akti nr. 106/1, dt. 7.7.2017.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për këshillimin dhe asistencë në terren”, akti nr. 183, dt. 9.5.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë veteriner”, akti nr. 20, dt. 31.3.2014.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë veteriner”, akti nr. 145, dt. 26.4.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike”, akti nr. 85, dt. 3.7.2019.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për mjedisin”, akti nr. 207, dt. 9.6.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për investimet”, akti nr. 3, dt. 4.2.2015.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për PAK”, akti nr. 44, dt. 11.4.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për PAK dhe Ndihmën Ekonomike”, akti nr. 208/1, dt.16.6.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për biznesin e vogël”, akti nr. 27, dt. 23.2.2017.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist i nivelit të lartë për biznesin e madh”, akti nr. 34, dt. 28.2.2017.

- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i nivelit të lartë për taksën familjare dhe taksën e tokës bujqësore”, akti nr. 21, dt. 23.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i nivelit të lartë për kontrollin dhe inspektimin”, akti nr. 106, dt.7.7.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor i Drejtorisë Juridike”, akti nr. 180, dt. 9.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Zyrë së prokurimeve”, akti nr. 66, dt. 25.4.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i nivelit të lartë për IT”, akti nr. 108, dt. 16.10.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës”, në Njësinë Administrative nr. 1, akti nr. 25, dt. 1.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i ndihmës ekonomike”, në Njësinë Administrative nr. 1, akti nr. 102/1, dt. 12.10.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës”, në Njësinë Administrative nr. 3, akti nr. 17, dt. 23.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës”, në Njësinë Administrative nr. 4, akti nr. 49, dt. 27.2.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Bubullimë, akti nr.118, dt. 25.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Bubullimë, akti nr.177/1, dt. 3.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor financë/arkiv/protokoll”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 102, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 103, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 124, dt. 25.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Dushk, akti nr. 40, dt. 7.3.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Karbunarë, akti nr. 67, dt. 19.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i tatim-taksave”, në Njësinë Administrative Ballagat, akti nr. 115, dt. 20.7.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Ballagat, akti nr. 108, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i financës”, në Njësinë Administrative Fier Shegan, akti nr. 79/1, dt.1.9.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i tatim-taksave/arkëtar”, në Njësinë Administrative Krutje, akti nr.101, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK”, në Njësinë Administrative Krutje, akti nr.104, dt. 6.7.2017.

2. Punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, dhe \*\*\*\*\*, të rikthehen në pozicionin e punës ku kanë emërimin e rregullt në shërbimin civil, si punonjës ekzistues, parashikuar nga neni 67 i ligjit. Në rastet e pamundësisë për t'u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, të bëhet sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori ku ata i plotësojnë kërkesat specifike për vendin e punës.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit janë vende vakante, të hartohen përshkrimet e punës sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.
4. Njësia përgjegjëse, të shpallë menjëherë për t'u plotësuar pozicionet e shërbimit civil që, në kuptim të ligjit, janë vende vakante dhe ato të plotësuara në kundërshtim me ligjin dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit, duke realizuar procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive, sipas strukturës që është në fuqi në momentin e zbatimit të detyrave të këtij vendimi.
5. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*.
6. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes, i cili është finalizuar me vendimin nr. 10, datë 7.3.2018, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt si më sipër.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **5 (pesë) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lushnje, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil,



nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Lushnje, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Fier. Njësia Përgjegjëse të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**